

D E K R E T
Nr.750, datë 11.1.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”
NDRYSHUAR NE LIGJIN NR.7654, DATË 24.12.1992 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN
NR.7609 DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të ministrit të Financave,

D E K R E T O J

Neni 1

Neni 17, i ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” ndryshuar me ligjin nr.7654, datë 24.12.1992 “Për një ndryshim në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, të ndryshohet si më poshtë:

“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi i paguar ose që duhet të paguhet për mallrat kur ato shiten për eksport drejt territorit doganor të republikës së Shqipërisë. Vlera doganore përfshin çmimin e mallrave, shpenzimet e transportit dhe ato të sigurimit.

Kur organet doganore konstatojnë se çmimet e mallrave, shpenzimet e transportit dhe ato të sigurimit janë nën vlerat minimale të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, zbatojnë këto vlera minimale për llogaritjen e vlerës doganore.

Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Financave, nxjerr listat me vlerat minimale dhe bën ndryshimet në to në përputhje me koniunkturat ndërkombëtare të çmimeve të mallrave, tarifave të transportit dhe ato të sigurimit”

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

KUNDËRFIRMOHET

KRYEMINISTRI
ALEKSANDËR MEKSI

MINISTRI I FINANCAVE
PIRO DISHNICA